



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KESHILLI

Nr. 4738/prot.  
13

Pogradec, më 02.12/2024

VENDIM

Nr. 126, DATË 27 /11/2024

**MBI NJË NDRYSHIM NË V.K.B. NË NR. 105, DATË 22/09/2022, "Per  
Percaktimin e procedures per negocimin me zhvilluesit private qe shprehin interes te  
bashkepunojne me Bashkine Pogradec, nepermjet marreveshjes per pronat ne  
pronesi te saj"**

Bazuar ne nenin 8/2, neni 9 pika 1, nenpika 1.1 germa a, b, nenpika 1.2/c, nenit 23/14, 24/2 nenit 54 germa K te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", Kodi Civil, Ligji 8743 dt. 22.02.2001 "Per pronat e paluajtshme te shtetit", i ndryshuar, Ligjit 8744 dt. 22.02.2001 "Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore", te ndryshuar, Ligjit 107/2014 "Per planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" te ndryshuar, VKM 408 dt. 13.05.2015 "Per miratimin e rregullores te zhvillimit te territorit" te ndryshuar,

VENDOSI

1. Në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Pogradec me nr. 105, datë 22/09/2022, "Per Percaktimin e procedures per negocimin me zhvilluesit private qe shprehin interes te bashkepunojne me Bashkine Pogradec, nepermjet marreveshjes per pronat ne pronesi te saj" kapitullin III, "Shqyrtimi i kerkeses per shprehje intresi", pika 4, germA a). ndryshon si më poshtë:
  - a. Kerkesa e paraqitur nga subjekti privat eshte ne perputhje me elementet e planifikimit te territorit dhe PPV-ne e Bashkise Pogradec, ose ndërtimi i propozuar nga subjekti privat është në kategorinë e ndërtimeve të parashikuara nga neni 19 të VKM-së nr. 408, datë. 13.05.2015 "Per miratimin e rregullores te zhvillimit te territorit" te ndryshuar, verifikohet nëse trualli objekt marrëveshje është apo jo i nevojshëm për aplikimin e PPV-së, ndërsa kushtet dhe kriteret e lejës do të përcaktohen nga KKTU, atëhere se bashku me informacionin e siguruar ia percjellin Komisionit te Negocimit, duke njoftuar edhe zhvilluesin privat per keto veprime.
1. Ngarkohet Kryetari i Bashkise, Drejtoria e Pergjithshme Juridike, Drejtoria e Pergjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe Komisioni Negocimit per ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi.



2. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

**KRYETARE E KËSHILLIT**

Manjola **KAMOLLI**



1.Miratuar me 19 vota

2.Vota Pro 19

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 1

5.Zbardhur më date 02.12.2024